

Nr. K1/I214-6 Prot.
Nr. Dok. 202500941/6

Tiranë 08.05.2025

Lënda : Rekomandim për ndryshimin e kontratës së lidhur me studentët që akomodohen në Rezidencën Studentore Universitare

Z. RENATO PASHOLLARI
DREJTOR
REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE
"QYTETI STUDENTI", TIRANA 1

I nderuar z. Pashollari,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me nenin 13 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka filluar një hetim me iniciativë pas publikimit në media¹ të një rasti lidhur me detyrim të shtuar për pagesën e konviktit nga studentët. Në kronikë raportohej se këtë vit, nga administrata e konviktit, u është thënë studentëve se duhet të paguajnë konviktin për të paktën 6 muaj paradhënie, kur pagesa mujore është 5500 lekë në muaj. Nëpërmjet kamerës së fshehtë dokumentohet se një punonjëse e administratës së konvikteve në "Qytetin Studenti", thotë se kushti është që studentët të paguajnë për 6 muaj menjëherë, që të mund të regjistrohen në konvikt. Por në disa godina të tjera pagesa është mujore dhe nuk ka asnjë urdhër të ndryshëm, çka pohohet edhe në zyrat e Administratës së Qytetit Studenti.

Për nevoja të vlerësimit të këtij rasti, me tonat nr. 202401628/2, datë 14.11.2024 dhe nr. 202401628/4, datë 23.12.2024 i jemi drejtuar Rezidencës Studentore Universitare "Qyteti Studenti", Tirana 1 sh.a. (RSU Nr.1), me kërkesë për informacion dhe shpjegime, si dhe me kërkesë për vënien në dispozicion të një kopje të Rregullores së Brendshme, e cila përmendet në pjesën hyrëse të Kontratës tip që na u vendos në dispozicion gjatë hetimit administrativ.

Rezidenca Studentore Universitare "Qyteti Studenti", Tirana 1, me shkresat nr. 1679/1, datë 25.11.2024 dhe nr. 1679/3, datë 08.01.2025 na ka përcjellë informacionet, shpjegimet dhe dokumentacionin e kërkuar. Ky institucion na ka informuar se në momentin e regjistrimit, studentët nënshkruajnë kontratën e akomodimit, në nenin 3 të së cilës përcaktohet qartësisht tarifa dhe mënyra e pagesës. Sipas këtij përcaktimi (referuar edhe kontratës, modeli i së cilës na është vënë në dispozicion), pagesa për akomodim është e përcaktuar në kontratë si një tarifë vjetore dhe kryhet paradhënie në llogarinë bankare të shoqërisë, citojmë:

¹ <https://tvklan.al/pagesat-jane-6-muaj-e-lart-administrata-e-konviktit-shpik-rregull-te-ri>

“Neni 3

Tarifa dhe mënyra e pagesës

Tarifa e akomodimit është ____ lekë për vitin akademik, dhe kryhet paradhënie në llogaritë bankare të shoqërisë.”

Megjithatë, duke pasur parasysh rëndësinë e mbështetjes financiare ndaj studentëve, ky institucion ka ndjekur praktikën që tarifa të mund të paguhet edhe me këste mujore, në rastet kur studenti paraqet kërkesë pranë Drejtorisë së Shërbimeve Studentore në mënyrë që të ofrohet fleksibilitet dhe t’iu lehtësohet përmbushja e detyrimeve financiare. Kjo iniciativë është pjesë e përpjekjeve për të mbështetur sa më mirë studentët dhe për të përmirësuar përvojën e tyre gjatë qëndrimit në rezidencë. Më tej, në përgjigjen e Rezidencës Studentore Universitare “Qyteti Studenti”, Tirana 1 sh.a, theksohet gjithashtu se kjo shoqëri funksionon me të ardhurat e qirave të studentëve dhe parashikimi për pagesën 6 mujore ose 1 vjeçare shërben për të planifikuar shërbimet që u ofrohen studentëve për jetesën e tyre gjatë kohës së qëndrimit për vitin akademik.

Nga shpjegimet dhe të dhënat e ofruara, rezulton se praktika aktuale e ndjekur nga Rezidencat Studentore Universitare, u mundëson studentëve të paguajnë tarifat e akomodimit me këste mujore, ndryshe nga përcaktimet e kontratës ekzistuese, që kërkojnë pagesën e tarifës vjetore paradhënie, pikërisht me qëllimin për të ofruar më shumë fleksibilitet dhe mbështetje financiare ndaj studentëve. Megjithatë, kontrata ekzistuese, duke kërkuar pagesën vjetore të tarifës përpara akomodimit, vendos një barrë ekonomike disproporcionale mbi studentët, veçanërisht për ata me mundësi të kufizuara financiare. Edhe pse në praktikë RSU ofron mundësinë e pagesave mujore nëpërmjet kërkesës individuale, kjo nuk pasqyrohet në tekstin e kontratës, duke e bërë fleksibilitetin një përjashtim dhe jo një të drejtë të barabartë për të gjithë, dhe duke krijuar një situatë të paqartë juridike dhe rrezik për pabarazi në trajtim.

Kontrata e akomodimit e lidhur midis studentit dhe institucionit "Rezidenca Studentore Universitare Nr.1" është një dokument standard (“kontratë tip”) që përmend si bazë ligjore nenet 801-825 të Kodit Civil dhe rregulloren e brendshme të institucionit. Ajo hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dyja palët dhe është e vlefshme për një vit akademik. Sipas dokumentacionit bashkëlidhur nga RSU në përgjigje të kërkesës së Avokatit të Popullit, nuk rezulton që kjo kontratë të jetë miratuar me një vendim institucional ose me përfshirjen e përfaqësuesve të studentëve.

Kushtet e përgjithshme të kontratës janë standarde dhe njëanshme në favor të institucionit, ato përcaktojnë detyrime të shumta për studentin, dhe i japin të drejtën institucionit për të ndërprerë kontratën në mënyrë të njëanshme për shkelje të kontratës apo rregullores. Studentit i mbeten pak mundësi për të negociuar apo kundërshtuar kushtet e vendosura. Në thelb, kontrata më shumë merr natyrën e një akti administrativ sesa një marrëveshje dypalëshe e ekuilibruar.

Duke u mbështetur në bazën ligjore të kontratës dhe në praktikën aktuale të ndjekur nga Rezidenca Studentore Universitare, Avokati i Popullit vlerëson se modeli ekzistues i kontratës, i cili parashikon pagesën e plotë të tarifës vjetore paraprakisht, duhet të rishikohet, me qëllim që të formalizohet fleksibiliteti në pagesë dhe të përfshihet qartësisht mundësia për shlyerjen e tarifës në këste mujore.

Për sa më sipër, me qëllim garantimin e standardeve më të larta në ofrimin e shërbimeve për studentët, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, si dhe në bazë të neneve 2 dhe 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku

përcaktohet se: *“Avokati i Popullit është nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend” dhe “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

REKOMANDOJMË:

1. Rishikimin e modelit të kontratës të lidhur me studentët për akomodimin e tyre në Rezidencën Studentore Universitare, duke formalizuar të drejtën për të shlyer detyrimin me këste mujore;

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398 datë 12.05.2005, ku përcaktohet se:

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

lutemi, pas shqyrtimit, të n’a vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Vilma SHURDHA

d.v.